

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

PROJEKTLIGJI “PËR TRAJTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E MJETEVE RRUGORE, LUNDRUESE, TË KONFISKUARA, SI PASOJË E SEKUESTRIMIT, NDALIMIT ADMINISTRATIV, NGA POLICIA E SHTETIT DHE MJETEVE TË TJERA”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore, lundruese, të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ, nga Policia e Shtetit dhe mjeteve të tjera”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- rregullimin e procedurave të trajtimit, administrimit dhe nxjerrjes në ankand publik të mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga Policia e Shtetit, si dhe mjeteve të tjera.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 6 qershor 2024 deri më 3 korrik 2024.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>:
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

- Për hartimin e këtij projektligji u ngrit Grupi i Punës, me urdhër të Ministrit të Brendshëm, nr. 21 prot., datë 19.01.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektligjit “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasoje e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga policia e shtetit dhe mjeteve të tjera, deri në datën 31.12.2022”, me përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe në takimet për diskutimin e problematikave dhe propozimet për zgjidhjen e tyre, u ftuan përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- Më datë 09 shkurt 2024, në orën 11:00, në mjediset e Ministrisë së Brendshme, Zëvendësministri i Brendshëm, z. Besfort Lamallari thirri në takim in e parë grupin e punës në kuadër të zbatimit të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm. Qëllimi i takimit u përqendrua tek nevoja për gjetjen e një mekanizmi i cili do të mundësojë zgjidhje efikase për problematikën e krijuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, ku aktualisht ndodhen rreth 16000 mjete, me statuse të ndryshme, për të cilat ndër vite nuk po jepet një zgjidhje për të kryer procedurat e mëtejshme.
- Më datë 27 shkurt 2024, në orën 11:00, në mjediset e Ministrisë së Brendshme, Zëvendësministri i Brendshëm, z. Besfort Lamallari thirri në takim in e dytë, grupin e punës në kuadër të zbatimit të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm. Qëllimi i takimit u përqendrua tek nevoja për shqyrtimin e mundësive ligjore, i cili do të mundësojë zgjidhje efikase për problematikën e krijuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, ku aktualisht ndodhen rreth 16.000 mjete, me statuse të ndryshme, për të cilat ndër vite nuk po jepet një zgjidhje për të kryer procedurat e mëtejshme. Për këtë arsye, u ftuan në takim dhe përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji është hartuar me qëllim rregullimin e procedurave të trajtimit dhe administrimit të mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga Policia e Shtetit dhe mjeteve të tjera. Qëllimi i hartimit dhe miratimit të këtij projektligji vjen si pasojë e nevojës për gjetjen e një mekanizmi, i cili do të mundësojë zgjidhje efikase për problematikën e krijuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, ku aktualisht ndodhen 16.445 mjete, me statuse të ndryshme, që kanë krijuar mbarjtje dhe një problematikë të

vazhdueshme, e për të cilat ka pasur zgjidhje për të kryer procedurat e mëtejshme, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Me anë të këtij projektligji do të zgjidhen disa probleme emergjente, si:

- a) mjetet rrugore, të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit apo ndalimit administrativ nga organet e Policisë së Shtetit, të cilat nuk kanë statusin juridik “provë materiale”;
- b) mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me lejet përkatëse të qarkullimit/lundrimit nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit;
- c) mjetet rrugore dhe lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare (me ose pa targa regjistrimi/leje qarkullimi/lundrimi nga një shtet i huaj) dhe që janë të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit apo ndalimit administrativ nga organet e Policisë së Shtetit;
- ç) mjetet e braktisura, të cilat janë identifikuar si objekt i kryerjes së veprës penale, por autori i veprës penale nuk njihet apo nuk është gjetur dhe nuk kanë dokumentacion, mjete që janë ndaluar administrativisht për mangësi në dokumentacion, mjete të braktisura për të cilat nuk është shfaqur interes t’i tërhequr apo mjete të debitorëve.

Propozimet

Projektligji nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike, por vjen si një domosdoshmëri për rregullimin e një situate me rrezik të madh potencial, që mbajnë këto mjete, për mjedisin dhe sigurinë publike, pasi në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, si zjarre apo shkarkime elektrike, dëmet do të jenë të mëdha prej karburantit dhe lubrifikantëve që kanë këto mjete rrugore apo lundruese. Ky projektligj është në përputhje me objektin dhe fushën e veprimtarisë së strukturës së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Gjithashtu, ky projektligj vjen si domosdoshmëri për shmangien në vijim të dëmit ekonomik dhe konflikteve të krijuara me pronarët e pikave të ndalimit administrativ të mjeteve.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t’i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë ky projektakt në zgjidhjen e problematikës së mjeteve të mbetura stok në komisariatet e policisë?